Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**08.10.2024**	**17.10.2024**	**2024/0936**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.10.2024, OE "N.T. „Fer-Petroll"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0936, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "PUNIM I RRETHOJES SË SIGURISË NË KAMPIN VRELLA DHE PORTA HYRËSE ME KONTROLL" me nr. të prokurimit: "214-24-6407-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 422,472.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 27.06.2024, NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE ose PERMIRESIM I GABIMIT: 27.06.2024, data e hapjes së ofertës: 22.07.2024, data e vendimit për dhënien e kontratës: 19.09.2024 , data e njoftimit me letër standarde: 18.09.2024.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- **Neni 1 i LPP-së /Qëllimi**
- **Neni 6 i LPP-së /Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Neni 52 i LPP-së/ Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhur**
- **Neni 59 i LPP-së/Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve**
- **Neni 60 i LPP-së/ Kriter për dhënie e Kontratës**
- **Neni 64 i LPP-së/ Dëshmitë e kërkesave**
- **Neni 67 i LPP-së/ Provat shkresore**
- **Neni 69 i LPP-së/ Aftësitë teknike dhe profesionale**
- **Neni 70 i LPP-së/Standardet për Sigurimin e Cilësisë**

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

- **4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit / paragrafi 4.1 dhe 4.2**
- **24. Publikimi i njoftimeve të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik të Kosovës / paragrafi 24.4**
- **26. Kriteret e Përzgjedhjes / paragrafi 26.1 dhe 26.2**
- **28. Kriteret e Dhënies së Kontratës / paragrafi 28.1**
- **41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve /paragrafi 41.3, 41.5 dhe 41.12**

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Kerkesa 1- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Deshmi 1. OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ne vendin e Themelimitë**

12

B17 Dosjea e Tenderit – Pune – Procedur e Hapur

		tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 650,000.00 €	**për tri vitet e fundit.**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 500,000.00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Deshmi 1-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve. • Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve ose raportet e pranimeve teknike përfundimtar**
		Kerkesa 2-Lista e stafit profesional të operatorit <u>ekonomik me</u> përbërje si ne vijim **•Një (1) inxhinier i diplomuar drejtimi Arkitektur (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 5 vite pas**	**Deshmi 2-Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si ne vijim • Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, •Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar, •CV-it- e inxhinierëve,**

		diplomimit • **Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit .** • **Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit** **Një (1) • Gjeodet I diplomuar, i Licencuar (Inxhinier, master, apo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit** **• Nje Teknik te Saldimit**	**(në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës) •Për Gjeodet duhet te jetë edhe Licenca e punës valide e noterizuar Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin •Per Teknik te saldimit Deshmi çertifikata e noterizuar Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin**
		Kerkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher te kontrates me profesion inxhinier i diplomuar ose master (jo beqellar) Inxhinjer i Ndërtimtaris -(Drejtimi Konstruktiv) kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit	**Deshmi 3-Vendim me shkrim për caktimin te menaxherit, pergjegjes per implementim te projektit- i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar , CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës**
		Kerkes 4-OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosuar nga OE me pajisjet ne vijim **• 1 kamion kiper me kran pesha max e ngarkimit min 3-7.5 ton** **• 2 eskavator 19000-24700 kg** **• 1 cilindër për ngjeshje** **• 4 kamion pesha e ngarkimit 11 deri 26 ton** **• 1 Makinë për**	**Deshmi 4- OE duhet te ofrojë listën e Automjeteve te kërkuara për ekzekutimit të punëve e vulosur dhe nënshkruar, për automjetet që kanë regjistrim të dëshmohet me librez valide me foto. Automjetet dhe Mjetet e punes gjithashtu te deshmohen me foto si dhe deklaratë mbi posedimin e tyre apo marrëveshje mbi marrjen me qera për projektin në fjalë.** **Deshmi per:** **1 Çekiq mini eskavator 1.5 deri 3 ton :** **DUD, fature apo libreza nëse regjistrohet (kërkohej dëshmi**

		prerjen e asfaltit dhe betonit • 1 Çekiq mini eskavator 1.5 deri 3 ton	për pajisjen te paktën njëra nga keto deshmi)
		Kerkesa 5-• Kompania duhet të ofroj një person të çerfifikuar për mbrojtje nga zjarri, mund të jetë pjesë e stafit profesional i punëtoreve	Deshmi 5-OE duhet te ofroj Certifikate te Noterizuar Deshmi kontraten ose para kontraten e punës valide me punëdhënësin□
		Kerkese 6 -OE duhet të ofroj një person të çerfifikuar për mbrojtje dhe siguri në punë sipas ligjit 04-L-161.	Deshmi 6- Certifikata sipas Ligjit 04-L-161 e noterizuar Deshmi kontraten ose para kontraten e punës valide me punëdhënësin
		Kerkesa -7 OE duhet te dëshmojë se është i certifikuar me ISO 18001 2007 ose 45001 2018 për siguri dhe shëndet ne pune gjate ndërtimit.	Dëshmi -7 Certifikata ISO 18001 2007 ose 45001 2018 (Valide) – Kopje e noterizuar
		Kerkesa 8-OE duhet te dëshmojë se është i certifikuar ne fushen e Ndertimtarise per ISO standarde për menaxhim te cilësisë ISO 9001 2015 ose 9001 2018	Dëshmi 8 Certifikata ISO 9001 2015 ose 9001 2018 (Valide) – Kopje e noterizuar
		Kerkesa 9- OE duhet te ofroj nje Liste te Punetoreve	Deshmi 9- OE duhet te ofroj Listen e Punetoreve te nenshkruar dhe Vulosur

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papergjegjshem.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i pergjegjshem.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.T. „Fer-Petroll**

Sqarim i lendes

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 te LPP-se, me arsyetimin se ne i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë, rrjedhimisht pretendon se i rekomanduari për kontrate është i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, sqaron se fillimisht autoriteti kontraktues pas vlerësimit të ofertave, me datën 18.09.2024 e ka njoftuar OE ankues me letër standarde te tenderuesit të eliminuar me arsyetimin si ne vijim:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Ka dështuar ne kriterin:
Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se një ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 500,000.00 €
Deshmi 1-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se një ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vu Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të n dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e p ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të

Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), p duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autori

- Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca.

Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve os e pranimeve teknike përfundimtar
Ne liste te kontratave OE nuk ka arritur te dëshmoj kontrata sipas kriterit ne DT dhe Njoftim per Kontrate. OE pranuar kontratat ne numrin rendor 5 dhe 6 (ndertim) ne vlere prej 284,710.2 euro

OE ka dështuar ne kriterin.
Kërkesa 2-Lista e stafit profesional të operatorit ekonomik me përbërje si ne vijim

- Një (1) inxhinier i diplomuar drejtimi Arkitektur (apo master jo bachelor) me minimum përvojë p pas diplomimit
- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes (apo master jo bachelor) me minimum përvojë p pas diplomimit .
- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – (apo master jo bachelor) me minimum për 5 vite pas diplomimit

Një (1) • Gjeodet I diplomuar, i Licencuar (Inxhinier, master, apo bachelor) me minimum përvojë pune diplomimit

- Nje Teknik te Saldimit

Deshmi 2-Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin in si ne vijim • Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, •Diploma e inxhinierëve përkat lëmis së kërkuar e noterizuar, •CV-it- e inxhinierëve, •Referencat mbi përvojën e punës (në referenca jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës) •Për Gjeodet duhet te jetë edhe Licenca e punës noterizuar Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin •Per Teknik te saldimit Deshmi çerti noterizuar Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin
OE ka dështuar ta dëshmoj përvojën dëshmi për Arkitekt, mungojne deshmit sipas kriterit ne dT dhe Njoftim per K
Ka dështuar te dëshmoj
Dëshmi mbi Menaxherin e projekit, vendimi gjendet ndërsa dëshmitë tjera si: CV, Kontrate, përvoja , diplo gjinden ne oferte.
OE gjithashtu ka deshtuar te ofroj dëshmi foto për mjetet e punës , për kamion kiper dhe cekiq te eskavatorit
Andaj OE I refuzohet oferta dhe është I papërgjegjshëm.

Pretendimi nr. 1.

Lidhur me arsyen e pare të eliminimit te OE ankues, ku AK-ja është deklaruar se: Ne liste te kontratave OE nuk ka arritur te dëshmoj kontrata sipas kriterit ne DT dhe Njoftim për Kontrate. OE-se i janë pranuar kontratat ne numrin rendor 5 dhe 6 (ndërtim) ne vlere prej 284,710.2 euro

Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë arsyetim te AK-se, sqaron se AK-ja ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate ka kërkuar:

Kerkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 500,000.00 €

Deshmi 1-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve. • Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve ose raportet e pranimeve teknike përfundimtar

Eksperti shqyrtues pas analizimit te dokumentacionit sqaron se OE ankues ne ofertën e tije ka dorëzuar listën e kontratave si me poshtë :

LISTA E PUNEVE TE KRYERA - FER PETROL

Nr.	EMRI I PROJEKTIT/VENDI	Nr.prokurimit	Data e nenshkrimit	Vlera kontrates	Data perfundimit	Vendi realizimit	Referenca/Pranim Teknik	Autoriteti kontraktues
1	Ndertimi I rruges Vuqak Terdec	611-19-6808-5-2-1	28.10.2019	328,641.14	12.12.2022	Drenas	PO	K.K. DRENAS
2	Lot III Asfaltimin E Rrugeve Te Fshatrave Baice, Krajkove, Damanekë Projekt Dy Vjeqare	611-21-063-521	11.08.2021	86,623.00	11.02.2022	Drenas	PO	K.K. DRENAS
4	Ndertim I infrastruktures (Asfaltim dhe Kubezim) ne Drenas I II III dhe IV-Projekt Dy Vjeqare	611-20-065-521	09.09.2020	249,806.86	09.12.2021	Drenas	PO	K.K. DRENAS
	Ndertim I infrastruktures (Asfaltim dhe Kubezim) ne Drenas I II III dhe IV-Projekt Dy Vjeqare	611-22-071-521	20.09.2022	273,376.10	19.12.2023	Drenas	PO	K.K. DRENAS
	Ndertimi I Urave dhe Mureve Mbrojtese Projekt dy vjeqare	611-21-071-521	25.08.2021	259,280.22	15.06.2023	Drenas	PO	K.K. DRENAS
	Ndertimi I Urave dhe Mureve Mbrojtese Projekt dy vjeqare-Aneks	611-22-049-525r	08.07.2022	25,430.00	15.06.2023	Drenas	PO	K.K. DRENAS
	Sanimi I rreshqitjes se rruges ne hyrje te Autostrades nga rruga Nacionale N2 ne Mazgit (Zona Kadastrale Obiliq)	205-21-8994-5-2-1	18.02.2022	269,996.32	13.11.2023	Mazgit	PO	MMPHI
	Sanimi I rreshqitjes se rruges ne hyrje te Autostrades nga rruga Nacionale N2 ne Mazgit (Zona Kadastrale Obiliq)-Aneks	205-23-6414-5-2-5	03.07.2023	18,549.13	13.11.2023	Mazgit	PO	MMPHI
	Asfaltimi rruges dhe kubezimi ne Drenas I,II,II dhe IV-Projekt dy vjeqar Lot II-Rregullimi I tregut ne Drenas(Asfalt)	611-23-8629-511	13.10.2023	142,042.20	21.12.2023	Drenas	PO	K.K. DRENAS
				1,653,744.97				

Eksperti shqyrtues, sqaron se arsyetimi i dhënë nga AK-ja, ne letrën standarde eshte pjesërisht i qëndrueshëm per faktin se AK-ja eshte dashur te kerkoje sqarime shtese dhe nga kontratat e prezantuara te nxjerr vlerën e punëve te ngjashme sepse përderisa AK-ja ne dosje te tenderit e ka përmendur edhe termin kontrata te ngjashme atëherë nuk mund te eliminohet nje operatore ekonomik me automatizëm.

Eksperti shqyrtues, poashtu sqaron se OE ankues lidhur me kerkesen e dosjes se tenderit ku AK-ja ka kërkuar kontrata te njëjta apo te ngjashme, pretendon se AK-ja me kete rast ka krijuar konfuzitet tek OE-te, sepse sipas OE ankues eshte dashur te kërkohen kontrata vetëm te ngjashme apo kontrata te njëjta.

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim sepse sipas nenit 108/A eshte dashur qe ne fazën e kritereve te parashtroni kërkesë per rishqyrtim lidhur me këto pretendime.

Pretendimi nr. 2.

Lidhur me arsyen e dyte të eliminimit te OE ankues, ku AK-ja është deklaruar se:. OE ka dështuar ta dëshmoj përvojën dëshmi për Arkitekt, mungojnë dëshmitë sipas kriterit ne DT dhe Njoftim për Kontrate, ka dështuar te dëshmoj:

Eksperti shqyrtues pas analizimit te dokumentacionit sqaron se OE ankues ne ofertën e tij e ka dorëzuar listën e

Punëtoreve, ku ne piken 3 te listës se punëtoreve figuron Inxhinieri i arkitekturës dhe lidhur me përvojën e tij OE ankues e ka dorëzuar CV-in përmendet vetëm nje projekt i vitit 2022 deri ne vitin 2023.

Lidhur me kete arsye te eliminimit eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se duhet te kërkohen sqarime shtese sepse sipas Udhezuesit operative per prokurim publik, ne rastet kur nuk dorëzohet CV-ja, AK-ja obligohet te kerkoje sqarime sipas këtij udhezuesi:

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk mund te kërkohen sqarime shtese lidhur me CV-in e inxhinierit per faktin se OE ankues e ka dorëzuar CV-in e inxhinierit ne fjale, mirëpo nuk i plotëson kërkesat e AK-se lidhur me përvojën dhe ne rastet kur dorëzohet CV-ja dhe nuk i përmbush kërkesat e AK-se atëherë sipas këtij udhëzuesi konsiderohet se nuk eshte plotësuar kushti administrativ.

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm

Pretendimi nr: 3

Lidhur me arsyen e eliminimit qe te beje me qe ka te beje me deshmit e menaxherit te projektit, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja ka kërkuar pese (5) vite pervoje pune pas diplomimit dhe njëherit ka kërkuar Inxhinier te diplomuar apo Master te ndërtimtarisë.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se me te drejte e ka eliminuar OE ankues lidhur me përvojën e inxhinierit sepse menaxheri i caktuar nga OE ankues ka diplomuar (Master) me 28 Mars 2024 dhe rrjedhimisht nuk mund te deshmoje se ka pervoje 5 vjeqare.

Lidhur me kete çështje eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ne ankesën e tij ka dorëzuar dëshmi tjera lidhur mirëpo te njëjtat nuk mund te merren parasysh sepse sipas dispozitave te LPP-se, nenit 59 perben ndryshim material te ofertës.

Kerkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher te kontrates me profesion inxhinier i diplomuar ose master (jo beqellar) Inxhinjer i Ndërtimtaris - (Drejtimi Konstruktiv) kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Deshmi 3-Vendim me shkrim për caktimin te menaxherit, pergjegjes per implementim te projektit- i nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e noterizuar , CV dhe referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës

Pretendimi nr: 4

Lidhur me arsyen e trete të eliminimit te OE ankues, ku AK-ja është deklaruar se: OE gjithashtu ka dështuar te ofroj dëshmi foto për mjetet e punës, për kamion kiper dhe cekiq te eskavatorit Andaj OE I refuzohet oferta dhe është I papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, lidhur me ketë arsyetim te AK-se, sqaron se AK-ja ne dosje te tenderit ka kërkuar:

Kerkes 4-OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosuar nga OE me pajisjet ne vijim

1 kamion kiper me kran pesha max e ngarkimit min 3-7.5 ton

1 Çekiq mini eskavator 1.5 deri 3 ton

Eksperti shqyrtues sqaron se arsyetimi i dhënë nga AK-ja, nuk qëndron sepse mbi bazën e

dëshmive te dorëzuara AK-ja eshte dashur te kerkoje sqarime lidhur me ato dëshmi sepse OE ankues ka ofruar DUD-a doganor te cilat janë dëshmi me te sakta se fotografit e pajisjeve.

Pretendimi nr.5

OE ankues pretendon se me datën 20.09.2024 ju ka drejtuar me kërkesë AK-se për qasje ne dokumente publike ndërsa AK-ja me datën 23.09.2024 e lejon qasjen ne dokument mirëpo sipas OE ankues ne kundërshtim me nenin 10 dhe 11.4 te LPP-se, autoriteti kontraktues ju ofron qasje te kufizuar me arsyetimi se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar deklaratën për sekret afarist.

Eksperti shqyrtues sqaron se, OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate e plotëson kërkesën e DT-se per kontrata dhe referenca, ekseprti shqyrtues sqaron se i rekomanduari per kontrate ka ofruar kontrata dhe referenca te natyrës se ngjashme dhe se i njëjti e plotëson kete kerkese te dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T. „Fer-Petroll**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi